



RAPORT VLERËSUES

**MBI NJOHURITË DHE NEVOJAT E GAZETARËVE TË KORÇËS DHE ELBASANIT
PËR ÇËSHTJET QË LIDHEN ME EMIGRACIONIN E PALIGJSHËM**

Tetor 2021



Ky raport u prodhua në kuadër të nismës “Siguria për Qeniet Njerëzore dhe Kufijtë - Luftimi i Kontrabandës së Migrantëve në Ballkanin Perëndimor”, mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Rrjetit i Informimit dhe Qytetarisë Aktive (Information Network and Active Citizenship) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Europian.

Emigracioni i paligjshëm dhe Shqipëria

Emigrimi njerëzor përfshin lëvizjen e njerëzve nga një vend në një tjetër me qëllim vendosjen përkohësisht ose përgjithmonë në një vend të ri me qëllimin për të jetuar apo punuar.

Shqipëria, siç raportohet edhe nga Shërbimi Informativ Shtetëror në vitin 2019, vijon të mbetet vend tranzit për kalimin e emigrantëve të paligjshëm, marrë parasysh se rruga ballkanike vijon të mbetet linjë e rëndësishme për emigracionin ilegal që shkon drejt Evropës¹. Fluksi i emigrantëve të paligjshëm që kanë hyrë nëpërmjet kufirit të gjelbër, në jug dhe juglindje të Shqipërisë, ka shënuar rritje të djeshme. Rrjete të trafikut njerëzor po përdorin këtë kontingjent për kalime të paligjshme kundrejt përfitimeve financiare, nga kufiri i gjelbër përgjatë lëvizjes në vende të ndryshme, duke iu mundësuar pajisjen me dokumente false, lehtësi dhe udhëzime për itinerarin.

Një situatë e tillë në vitin 2019, e deklaruar zyrtarisht, mbështetet edhe nga një raport i vitit 2020 nga “Nisma Globale kundër Krimin të Organizuar” ‘Spot prices: analizimi i fluksit të njerëzve, drogave dhe parave në Ballkanin Perëndimor²’, që kur flet për Shqipërinë deklaron se numri i emigrantëve të paligjshëm në Shqipëri u rrit nga 1978 në vitin 2013 në 11 971 në vitin 2020. Rritja ka qenë veçanërisht dramatike që nga viti 2018, kur u bë më e vështirë për azilkërkuesit dhe emigrantët të kalonin nga Greqia në Maqedoninë e Veriut, duke i shtyrë ata më larg në perëndim të Shqipërisë. Pikat më të njohura të hyrjes në Shqipëri për azilkërkuesit dhe emigrantët janë Kakavija në Gjirokastrë dhe Kapshtica në Korçë. Sapo hyjnë në vend, ata kanë tendencën të drejtohen drejt kryeqytetit, Tiranës (ku ka një kamp në periferi në Babrru), dhe pastaj në veri përmes Shkodrës për në pikën kufitare Hani i Hotit/Bozaj në Malin e Zi ose për në Morinë në kufirin e Kosovës. Një alternativë më e shtrenjtë udhëtimi për në Durrës ose Vlorë dhe përpjekja për të mbërritur në Itali me skaf.

Rëndësia e medias në raportimin e emigracionit të paligjshëm

Media është një mjet komunikimi tepër i rëndësishëm. Në ditët e sotme, ku interneti ka filluar të hyjë në çdo familje dhe rrjetet sociale u japin mundësi të gjithëve që të thonë opinionin e tyre, aftësitë e gazetarëve për të dhënë lajmin e saktë marrin akoma më shumë vlerë.

Në kontekstin e emigrimit, media është kyçe në ofrimin e një informacioni të verifikuar, opinionin të informuar si dhe narrativë të balancuar de gjithëpërfshirëse³. Mënyra se si media mbulon

¹ <https://www.shish.gov.al/pages/lajme/siguria2019.html>

² https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/05/WB-Hotspots-3_AL-web.pdf

³ <https://en.unesco.org/themes/media-crisis-and-disaster-situations/media-coverage-migration>

migrimin do të ndikojë në gamën dhe cilësinë e informacionit të marrë nga publiku, veçanërisht emigrantët, si dhe në mënyrën se si shoqëritë e perceptojnë dhe lidhen me këtë çështje. Vetëm duke inkurajuar raportimin profesional dhe etik të mediave, mund të ndihmohet në forcimin e përgjigjeve të mediave dhe nxit diversitetin e përmbajtjes, audiencës, burimeve dhe sistemeve.

Rritja e kapaciteteve është e rëndësishme për gazetarët e medias me qëllim që të luajnë sa më mirë rolin e tyre si informues dhe edukues të publikut. Ndryshe nga sa ndodh në kryeqytet, ku media zotëron një rrjet të gjerë gazetarësh të cilët janë të fokusuar në fusha të ndryshme, në rrethet gazetarët lokalë shpesh janë të detyruar të mbulojnë të gjitha fushat, duke pasur kështu vështirësi në pasqyrimin e plotë e të thelluar të çështjeve të caktuara për shkak të njohurive të canguara. Ndryshimet e shumta ligjore që ndodhin në Shqipëri nuk janë një ndihmë për këta gazetarë, që duhet të jenë të përditësuar përgjatë gjithë kohës në të gjitha fushat, marrë parasysh se i njëjti individ mbulon politikën, ekonominë, sportin, investigimet apo çështje të tjera sociale në nivel lokal.

Për rrjedhojë, kur flitet për cilësi dhe rritje kapacitetesh, fokusi tek media lokale është i rëndësishëm. Pavarësisht kapacitetit të redaktorëve të mediave qendrore, nëse burimi i lajmit nuk është i saktë, në valën e ngarkesës që zakonisht kanë redaksitë dhe nxitimin për të prodhuar lajmin të parët, është e vështirë që lajmi të ndërtohet me cilësi.

Në këtë raport, synohet të vlerësohen kapacitetet e gazetarëve të rrethëve Korçë dhe Elbasan, si pasqyrues të lajmeve të emigracionit të paligjshëm me qëllim që të kuptohet se për çfarë kanë nevojë reale mediat në këto zona.

Metodologjia

Në total Korça dhe Elbasani kanë rreth 30 gazetarë që shërbejnë për mediat lokale dhe kombëtare. Një pjesë e konsiderueshme e tyre janë me një përvojë mbi një dekadë, gjithsesi ka një pjesë gazetarësh të rinj që po integrohen në tregun e punës në këto zona (marrë parasysh që edhe Fakulteti i Elbasanit nxjerr çdo vit të rinj të diplomuar në gazetari).

Për të bërë të mundur vlerësimin e njohurive dhe nevojave të gazetarëve aktivë lokalë për trajtimin e temave të emigracionit të paligjshëm në qarkun Korçë dhe Elbasan u realizua një pyetësor i cili u plotësua nga 19 gazetarë në të dy qarqet. Me qëllim që problematika të kuptohej më mirë, pyetësori u bë me pyetje të hapura dhe gjysmë të hapura. Pyetësorit iu përgjigjën 15 gazetarë dhe 4 gazetarë.

Numri i lartë i gjinisë femërore në përgjigje është në linjë me numrin e madh që gjinia femërore zë në totalin e gazetarëve në terren. Pjesa më e madhe e gazetarëve që iu përgjigjën pyetësorit ishte e moshës 18-35 vjeç.

Gazetarët që morën pjesë			
Gjinia	Femra	15	79%
	Meshkuj	4	21%
Mosha	18-25 vjeç	6	32%
	26-35 vjeç	9	47%
	36-45 vjeç	1	5%
	46-55 vjeç	3	16%

Duhet marrë parasysh se gazetarët lokalë kanë një nivel të lartë arsimor. Kështu, nga gazetarët që u ftuan në intervistë për çështjet e emigracionit, prej të cilëve dhjetë ishin nga Elbasani dhe nëntë nga Korça, që të gjithë kishin përfunduar studimet universitare, kurse një pjesë e madhe kishin mbaruar ose ndiqnin edhe studimet pasuniversitare.

Gjysma e gazetarëve që iu përgjigjën pyetësorit kishin mbi 10 vjet përvojë pune dhe vetëm një pjesë e vogël kishin deri në një vit përvojë pune. Një gjë e tillë është e rëndësishme për t'u marrë parasysh sepse ndihmon në vlerësimin e njohurive në përputhje me përvojën e gazetarëve në punën e tyre në terren.

Gjithashtu nga përgjigjet me gazetarët del në pah fenomeni i punësimit në disa media në të njëjtën kohë. Një në tre gazetarë në rrethet pohon se punon në disa media njëkohësisht.

Gjetjet mbi njohuritë dhe nevojat e gazetarëve për pasqyrimin e çështjeve që lidhen me emigracionin e paligjshëm

Gazetarëve që morën pjesë në këtë vëzhgim me qëllim hartimin e raportit vlerësues iu drejtuan pyetje të ndryshme lidhur me punën e tyre dhe me emigracionin e paligjshëm. Nga pyetjet rezulton se pothuajse të gjithë gazetarët e cilësojnë emigracionin e paligjshëm si një çështje të rëndësishme për zonën ku ata jetojnë. Gjithsesi, vetëm gjysma e tyre deklaruan se çështjet e emigracionit raportohen shpesh. Një në tre gazetarë u shprehën se këto çështje raportohen rrallë ndërkohë që dy prej gazetarëve deklaruan se këto çështje nuk raportohen fare.

Puna e gazetarëve kushtëzohet nga politikat redaksionale. Kështu, nga deklaratat e gazetarëve rezulton se redaktorët/pronarët e medias kanë një interes të gjysmuar lidhur me këto lajme, ndaj 50% e tyre deklaruan se janë të inkurajuar për të pasqyruar çështjet e emigracionit të paligjshëm, ndërkohë që pjesa tjetër deklaruan se nuk janë të inkurajuar. Mosinkurajimi për të publikuar lajme të tilla ul edhe mundësinë e thellimit të gazetareve në çështjet e emigracionit, duke çuar në prodhim të pakajmësishëm dhe që nuk kanë ndikim tek publiku.

Gjithashtu, fakti që gazetarët në rrethe nuk janë të ndarë në fusha por mbulojnë të gjithë sektorët e një qyteti bie në sy edhe prej njohurive që kanë dhe format dhe burimet që ata përdorin për të pasqyruar çështjet e emigracionit të paligjshëm.

Gazetarët u pyetën nëse ekzistonte një ligj për emigracionin e paligjshëm në Shqipëri. Dy të tretat deklaruan se ky ligj ekziston, ndërkohë që një e treta nuk ka njohuri për ekzistencën e një ligji të tillë. Vetëm një nga gazetarët deklaroi që Shqipëria nuk ka një ligj për emigracionin e paligjshëm.

Për të kuptuar më mirë njohuritë e tyre, gazetarët u pyetën se ku bazohen kur shkruajnë një artikull/lajm për emigracionin e paligjshëm. Rezulton se shumica e gazetarëve shohin deklaratat e policisë si burim kryesor, ndërkohë që më pak se një e treta bazohen në legjislacionin shqiptar. Gjithashtu, rezulton megjithëse shifrat zyrtare tregojnë rritje të rasteve të emigracionit të paligjshëm gjatë pandemisë⁴, nga gazetarët e pyetur, vetëm 58% e tyre pranojnë se rastet e emigracionit të paligjshëm janë rritur gjatë pandemisë 42% deklarojnë që këto shifra janë ulur, nuk e dinë ose e konsiderojnë të parëndësishme. Një gjë e tillë nxjerr në pah se për një pjesë të mirë të gazetarëve këto çështje nuk janë parësore, por gjithashtu mbështet faktin që gazetarët nuk janë të fokusuar në një fushë, çka bën që njohuritë e tyre të jenë të ulëta për shkak të mbingarkesës që u duhet të përballojnë.

Gazetarëve iu bënë edhe pyetje të hapura me qëllim vlerësimin e njohurive të tyre lidhur me autoritetet përgjegjëse për trajtimin e të huajve në Shqipëri. Nga përgjigjet rezulton se pjesa më e madhe e tyre njohin vetëm policinë si autoritet përgjegës, disa citojnë Ministrinë e Brendshme dhe në pak raste përmenden ambasadat, organizatat e ndryshme apo institucionet e pavarura si Avokatit i Popullit.

Për të ditur se sa thellohen gazetarët në lajmet e tyre, ata u pyetën edhe nëse kanë dijeni për rrugët që përdorin emigrantët e parregullt për të hyrë në Shqipëri. Gjysma e gazetarëve deklaruan se kishin dijeni për rrugët, megjithatë vetëm një pjesë e tyre dhanë detaje lidhur me këto rrugë. Pjesa më e madhe dhanë përgjigje të cunguara.

"Kufiri me shtetin grek, fshatra si Kapshtica, Tresteniku janë porta hyrëse për emigrantët e paligjshëm që futen në territorin shqiptar. Shtigjet me Greqinë dhe itinerari i përdorur është pothuajse i përsëritur. - Gazetare, Korçë

Nuk e di me se vijnë deri në kufi, por më pas me furgonë apo mjete që i transportojnë ilegalisht kundrejt pagesës. - Gazetar, Elbasan

⁴ <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2021/05/Spot-Prices-Analyzing-flows-of-people-drugs-and-money-in-the-Western-Balkans.pdf>

Kalojnë ilegalisht kufirin e gjelbër në Kapshticë për të shkuar drejt qyteteve bregdetare në Shqipëri. Meqë Pogradeci konsiderohet si pikë tranzit, edhe kapjet e emigrantëve aty janë më të mëdha. - Gazetare, Korçë

Emigrantët udhëtojnë me kilometra në këmbë për të mbërritur në zonat e banuara dhe më pas bien pre e "trafikanëve" të cilët u marrin shuma të ndryshme parash për t'i transportuar në kryeqytet ku shpeshherë i mashtrojnë duke i çuar në zona të afërta nga vendi i marrjes dhe i lënë në rrugë pasi iu kanë marrë paratë (ka raste pa fund). - Gazetare, Korçë

Emigrantët e paligjshëm vijnë në Shqipëri nga Greqia ose të organizuar vetë me grupe të mëdha ose të orientuar nga grupet kriminale në Greqi dhe më pas në Shqipëri, të cilët i transportojnë në formë stafete në drejtim të pikave kufitare me Kosovën, Malin e Zi apo portin e Durrësit. - Gazetare, Korçë

Gjithashtu, gazetarët u pyetën nëse kishin pasqyruar ndonjëherë arsyet që nxisin emigracionin e paligjshëm dhe/ose individët e përfshirë në të, qoftë ata që emigrojnë, qoftë ata që përfitojnë nga emigracioni i paligjshëm. Vetëm pesë prej gazetarëve pohuan se kishin punuar në këtë drejtim, ndërkohë që pak prej tyre dhanë detaje.

Emigrantët e Lindjes së Mesme janë zakonisht më të prekurit. Janë ata të cilët janë në situatë lufte e shohin arratinë si një jetë e re. Ndërkohë, ka nga ata të cilët i shohin vendet e BE-së si një vend më të mirë për të jetuar, punuar për veten dhe familjet e tyre. Një pjesë e emigrantëve kanë familjet në një nga vendet e BE-së dhe kërkojnë ribashkim. Ndërkohë transportuesit shqiptarë të cilët u ofrojnë largimin nga territori shqiptar, përfitojnë nga çmimet që përdoren në këtë treg, dikush nga vlerat e konsiderueshme shkel ligjin nëpërmjet shpërblimeve, dikush kryen rolin e transportuesit pasi mund të ketë probleme financiare dhe persona të sëmurë në familjes dhe pamundësia për të gjetur një punë e çon duke kryer veprë penale. - Gazetare, Korçë

Burimet e informacionit janë shumë të rëndësishme në vërtetësinë e lajmeve të pasqyruara. Për rrjedhojë, gazetarët u pyetën se cilat ishin institucionet që bashkëpunonin për të pasqyruar lajmet mbi emigracionin e paligjshëm. Rezulton nga përgjigjet se më shumë se gjysma e gazetarëve deklarojnë policinë si institucion bashkëpunues dhe vetëm katër prej tyre citojnë edhe Drejtorinë e Kufirit dhe Emigracionin. Vetëm në një rast përmenden prokuroria dhe gjykatat si autoritete me të cilat bashkëpunohet për të pasqyruar lajmet mbi emigracionin e paligjshëm. Një pjesë e gazetarëve nuk pranuan të flasin lidhur me burimet e tyre të informacionit kur pasqyrojnë lajmet për emigrimin e paligjshëm ose u shprehën se nuk bashkëpunojnë me asnjë.

Mendojmë se vlen të theksohet se nga përgjigjet e dhëna nuk ka diferencë në qëndrime, njohuri apo paraqitje të lajmeve midis gazetarëve me mbi 10 vjet përvojë apo gazetarëve me më pak përvojë.

Një pyetje e rëndësishme për gazetarët është edhe mënyra se si ata vetë e shohin raportimin për emigracionin e paligjshëm. Rezulton se mbi 40% e gazetarëve e shohin si të vlefshëm, 26% të rëndësishëm dhe 16% të parëndësishëm. Pjesa tjetër e vlerëson si të vështirë apo jotërheqës, por këto përqindje janë shumë më të vogla dhe thuajse të papërfillshme.

Për këto vlerësime gazetarët u ftuan të japin edhe arsye. Gazetarët që e konsiderojnë emigracionin si të rëndësishëm dhe të vlefshëm, japin si arsye: emigrimi lidhet me çështje të tjera (trafikimi, krimi i organizuar, zhvillimi në vendet e tjera etj), pasqyrimi i tij do të ndihmonte në uljen e fenomenit, pasqyron situatën ekonomike të personave të përfshirë, emigracioni i paligjshëm ndikon në sigurinë kombëtare, si dhe pasqyrimi reflekton punën e qeverisë shqiptare.

Njihesh me vështirësitë e popujve për t'u larguar për një jetë më të mirë. Ndërkohë është e rëndësishme sepse jetoj në një qark ku emigracioni është kthyer në një situatë të përditshme. – Gazetare, Korçë

Mendoj se është i rëndësishëm pasi abuzimi me emigrantët mund të jetë një mundësi për të hetuar. Ne duhet t'i trajtojmë mirë emigrantët nëse nuk duam që e njëjta gjë të na ndodhë edhe ne. – Gazetare, Elbasan

Çdo individ kërkon një jetesë më të mirë. Shumica prej tyre arrijnë ta shohin këtë jetesë jashtë vendit. Por jo të gjithë individët kanë mundësi ekonomike, financiare apo fizike që të lëvizin jashtë në mënyrë legale dhe dynden drejt kësaj zgjedhjeje, por jo vetëm; edhe individët që kanë mundësi financiare mendojnë se mënyra ilegale e emigrimit është më e sigurt se mënyra legale, kështu që bëjnë zgjedhjen më të lehtë. – Gazetare, Elbasan

Për ta minimizuar is fenomen dhe për të shmangur problematikat që sjell duhet të trajtohet shpesh si temë, p.sh.: në biseda televizive, kronika lajmesh, ndaj mendoj se është me rëndësi pasqyrimi i lajmeve mbi emigracionin e paligjshëm. – Gazetare, Korçë

Për t'u njohur me problematikat që vijnë nga klandestinët dhe se si i ka menaxhuar qeveria. – Gazetare, Korçë

Emigracioni i paligjshëm është temë mjaft delikate, e cila nuk ka ndikim vetëm në jetën e emigrantëve, por edhe tonën, sepse ardhja e tyre në Shqipëri, qoftë edhe përdorimi i vendit tonë si tranzit, ndikon në mënyrën tonë të jetesës, sigurinë tonë etj. – Gazetare, Elbasan

I vlefshëm sepse fenomeni po merr vit pas viti përmasa të gjera dhe menaxhimi i krizës së refugjatëve po bëhet gjithnjë dhe më i vështirë për vendet me potenciale të paktë si Shqipëria. – Gazetare, Korçë

Ndërkohë, një pjesë e gazetarëve e konsiderojnë të parëndësishëm pasqyrimin e këtyre informacioneve duke deklaruar si arsye kryesore faktin që Shqipëria ka një sërë problemesh

sociale më të mëdha se emigrimi i paligjshëm dhe se vetë shqiptarët janë emigrues, për rrjedhojë nuk përbën një problematikë që të tjerët po kalojnë ilegalisht kufirin.

Gazetarët u pyetën nëse mendonin se media kishte një rol të rëndësishëm në pasqyrimin e çështjeve të emigracionit të paligjshëm. Vetëm një gazetar u përgjigj "nuk e di", ndërsa pjesa tjetër deklaroi se roli i medias ishte i rëndësishëm. Lidhur me arsyet e kësaj rëndësie, ndër kryesoret ishin: informimi i publikut, analizimi i fenomenit, mbajtja e qeverisë nën presion me qëllim garantimin e të drejtave të emigrantëve.

Media vë në fokus problematikat e këtyre popujve, të cilët të lodhur nga kampet e qëndrimit në shtete të tjera udhëtojnë për një jetë më të mirë drejt Shqipërisë, udhëtojnë me ditë të tëra në kërkim të një jete më të mirë duke e përdorur si vend tranzit me shpresën e kalimit drejt vendeve të BE-së. Shteti shqiptar duhet të japë një zgjidhje konkrete për këta të fundit. – Gazetare, Korçë

Media duhet të pasqyrojë vështirësitë e hasura nga emigrantët për të ardhur drejt tokës sonë, si dhe si trajtohen nga vendasit. - Gazetare, Elbasan

Duhet të bëhet pasqyrimi dhe trajtimi në mënyrë të plotë, profesionale dhe të thelluar e problematikës së emigrantëve të paligjshëm, si dhe çfarë ofrojnë vendet pritëse si Shqipëria për fluksin në rritje të tyre. - Gazetare, Korçë

Media duhet të informojë publikun mbi rastet e shtuara të dhe të bëjë thirrje për mosneglizhencë nga shteti. - Gazetare, Elbasan

Media garanton të drejtat e emigrantëve dhe jep informacion për ta. Ndërgjegjësimi i publikut sjell ulje të fenomenit. - Gazetar, Korçë

Nevojat e gazetarëve lokalë për rritje kapacitetesh në fushën e emigracionit të paligjshëm

Nga gazetarët e intervistuar, vetëm njëri kishte marrë pjesë më parë në trajnime lidhur me çështjet e emigracionit, ndërkohë që pjesa tjetër nuk kishte qenë asnjëherë pjesë e programeve për rritjen e kapaciteteve në fushën e emigracionit. Rezulton se asnjë nga gazetarët me mbi 10 vjet përvojë nuk ka marrë pjesë në trajnime për emigracionin e paligjshëm.

Të pyetur se ku donin që të rrisnin më shumë njohuritë e tyre lidhur me emigrimin e paligjshëm, gazetarët u fokusuan në:

- Rritje kapacitetesh në legjislacionin shqiptar për çështjet e emigracionit të paligjshëm dhe emigracionit në përgjithësi
- Gazetaria investigative në çështjet e emigracionit
- Shkaqet e emigracionit të paligjshëm
- Format për parandalimin e fenomenit

- Kuadri ligjor për vendet tranzit të emigrantëve
- Institucionet shqiptare që merren me çështjet e emigrimit, fushat që mbulojnë dhe funksionimi i tyre.

Rritja e kapaciteteve të gazetarëve është shumë e rëndësishme. Redaksitë, por edhe donatorët dhe shoqëria civile duhet t'i kushtojnë një vëmendje më të madhe gazetarëve lokalë të cilët për shkak të profilit të tyre duhet të mbulojnë më shumë fusha sesa gazetarët që punojnë në kryeqytet dhe për rrjedhojë kërkon që ata të jenë gjatë gjithë kohës vigjilent.

Me rritjen e aksesit të internetit nga familjet shqiptare dhe ndikimin e madhe që media sociale aktualisht ka tek njerëzit, fluksi i informacionit që merret nga çdo familje është i ndjeshëm. Por ky informacion nuk vjen gjithnjë i filtruar. Ndaj është e nevojshme që të realizohet rritja e njohurive të gazetarëve dhe e kapaciteteve të tyre për ta dhënë lajmin sa më të saktë dhe për të ndikuar pozitivisht në shoqëri.